

### **Korniza e Performancës së Shkollës**

Përmbledhje e Informacioneve nga Takimet e Mbajtura në – 12 Tetor, 22 Tetor, 23 Tetor, 29 Tetor, 4 Nëntor dhe 12 Nëntor, 2013

---

Në takimet e Kornizës së Performancës së Shkollës të datave 12 Tetor, 22 Tetor, 23 Tetor, 29 Tetor, 4 Nëntor dhe 12 Nëntor, pjesëmarrësve u është kërkuar të ndajnë vlerat që ata gjejnë në shkollat e tyre dhe çfarë informacioni kanë të nevojshëm, kur marrin vendime për edukimin e fëmijëve të tyre. Më poshtë po renditim një përmbledhje të mendimeve të dhëna nga prindërit, familjet dhe pjestarët e komunitetit. Lista nuk përmban çdo gjë që është diskutuar, por reflekton rekomandimet e bëra nga pjesëmarrësit. Ju lutemi na kontaktoni nëpërmjet [performanceframework@philasd.org](mailto:performanceframework@philasd.org) *për rekomandime të tjera, ose për më tepër informacion.*

1. **Stafi:** mundësitë për librarë të certifikuar, këshilltarë, infermjerë, përzgjedhje në shkollë; raporti nxënës-mësues
2. **Efektiviteti i Edukatorëve:** efektiviteti i drejtorit dhe mësuesve, niveli i diplomimit, mundësitë dhe pjesëmarrja në kualifikimin profesional, mbajtja e mësuesve në shkollë; numri i viteve në shkollë, numri i viteve në Drejtorinë Arsimore
3. **Programi Mësimor & Mësimdhënia:** Materialet për programin mësimor dhe përqasja e tyre me Standardet e Përgjithëshme Bazë të Shtetit; rigoroziteti i programeve mësimore; krijimtaria e praktikave mësimore
4. **Arritjet e Nxënësve:** matja e arritjeve të nxënësve që është përtej performancës së testeve të standardizuara; matjet që kanë vlerë për Nxënësit me Edukim Special, ose të Nxënësve që Mësojnë Anglisht, aftësitë e të menduarit kritik, krijimtaria, performanca në lëndët e tjera veç Anglishtes dhe Matematikës
5. **Rritja:** rritja në të gjitha nivelet e performancës, arritja e progresit në nivelet i aftë
6. **Barazia:** bëni krahasim të ndershëm (jo renditje) duke marrë në konsideratë diferencat në popullatën e nxënësve, të stafit dhe të burimeve të tjera – krahasoni “mollët me mollë”
7. **Siguria:** incidentet serioze sipas kategorisë; pezullime të diferencuara të cilat tregojnë nxënësit, që ndëshkohen me shumë pezullime dhe me pezullime që lidhen me sigurinë; masat e sigurisë evidentohen nëpërmjet pyetsorëve; kualifikim profesional për mbajtjen e shkollave të sigurta; planet e sigurisë së shkollës; siguria e mjediseve rreth shkollës
8. **Formati:** përdorni sisteme informuese të thjeshta dhe transparente, për komunikimin e performancës së shkollës dhe krahasimin e shkollave; përdorni një sistem që bazohet në ngjyrat për përgjithësimin e performancës së shkollës
9. **Programet:** programe për librari, muzikë, art, atletikë, klube, programe dhe aktivitete pas shkollës, programe për pasurimin e dijeve

10. Përfshirja e Komunitetit: pjesëmarrja e prindit në shkollë; ekzistenca e grupeve të komunitetit të tilla si Shtëpia dhe Shkolla ( Home and School ) ose Komitetet Këshillimore të Shkollës (School Advisory Councils); klasat e prindërve; marrdhënia midis shkollës dhe komuniteteve që e rrethojnë, të tilla si bashkëpunimi i shkollës me organizatat e komunitetit; klima e shkollës të mirëpresë familjet dhe pjestarët e komunitetit
11. Pyetsorët: zëri i nxënësit, prindit , mësuesit dhe grupeve të komunitetit, prioritetet midis matësve të tjerë të performancës; pyetsorë për nxënës duke filluar nga klasa e 4<sup>t</sup>; përshtatje sipas nivelit të klasave
12. Afatet: në vitet në vazhdim, afishimi përpara afatit të fundit për aplikimet në shkollën e mesme, në mënyrë që nxënësit të përdorin materialet e duhura për vendimin që do të marrin për vazhdimin e shkollës së mesme
13. përgatitja për Kolegj & Punë: zgjedhja dhe vajtja në kolegj; pjesëmarrja dhe performanca në SAT/ACT
14. Frekuentimi: frekuentimi dhe ardhja me vonesë e mësuesve dhe nxënësve
15. Lehtësitë: mundësitë për bibliotekë
16. Ruajtja e kontigjentit të Nxënësve: masat për ruajtjen e kontigjentit të nxënësve gjatë vitit shkollor, në mënyrë të veçantë para sezonit të provimeve
17. Të tjera: informacion cilësor shtesë, që pasqyron me vërtetësi shpirtin, misionin dhe vlerat e shkollës

### **Mendime të tjera që janë marrë nëpërmjet E-mail**

---

1. Efektiviteti i Edukatorëve: Kredencialet mësimdhënëse të mësuesve të lëndëve jo kryesore; ankesat formale të fakultetit, ose personelit, plotësuar nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias (SDP), ose Departamenti i Arsimit (PDE); përcaktimi i kohës së drejtorëve për aktivitete jo mësimore
2. Programet Nxitëse: programe të cilat nxitin rezultatet e larta në testet e standardizuara
3. Financat/Buxheti: Shpenzimet për nxënësit të detajohen sipas burimeve të financimit (Federali, Shteti, Lokale, Private); buxheti për klasë
4. Mjedisi: konditat e paisjeve në shkolla